



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2022:182856

Datë: 20.06.2024

Numri i dokumentit: 05842809

KPPP.nr.685/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Arnis Dumani, në çështjen përmbartimore të kreditorit “Elektring” SH.P.K., me NUI: 810662652, me seli Çagllavicë, Prishtinë, kundër debitorëve 1. “EL CORPORATION” SH.P.K., me NUI: 810090522, me seli në rr. “Pajazit Ahmeti” p.n., në Gjilan dhe 2. A.SH., me numër personal 1231268789, me vendbanim në rr. “Pajazit Ahmeti” pn., Gjilan, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të dytë të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.185/22 të datës 21.05.2022 të plotësuar me datë 03.08.2022 të Përmbartuesit Privat Besnik H. Aliu, me seli në Ferizaj, jashtë seancës me datën 20.06.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

PRANOHET si i bazuar prapësimi i debitorit A.SH., ashtu që ANULOHET Plotësimi i urdhrin përmbartimor P.nr.185/22 i datës 03.08.2022 i lejuar nga Përmbartuesi Privat Besnik H. Aliu.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit për përmbartim të kreditorit “Elektring” SH.P.K., më datë 21.05.2024 ka lëshuar urdhrin përmbartimor P.nr.185/22 me të cilin ka lejuar përmbartimin mbi bazën e dokumenteve të besueshme – faturave: fatura nr.138/2021 e datës 25.10.2021, fatura nr.552/2020 e datës 22.06.2020, fatura nr.715/2020 e datës 27.07.2020, fatura nr.971/2020 e datës 18.09.2020 dhe fatura nr.658/2020 e datës 13.07.2020 me të cilin ka detyruar debitorin që në emër të borxhit t’ia paguaj kreditorit shumën prej 5,903.95€, si dhe shpenzimet e procedurës përmbartimore nën kërcënimin e përmbartimit të dhunshëm. Në të kundërtën përmbartimi të realizohet përmes bllokimit të llogarive bankare, sekuestrimin, e sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme të debitorit, dhe me shitjen e tyre të bëhet inkasomi i borxhit në llogari të kreditorit.

Debitori propozimin për përmbarrim dhe urdhërin përmbarrimor i ka pranuar me datë 13.04.2022, por ndaj të njëjtit nuk ka paraqitur prapësim.

Më tutje më datën 03.08.2022 kreditori ka dorëzuar te Përmbarruesi Privat një parashtrësë për zgjerimin e propozimit për përmbarrim të datës 08.04.2022, në bazë të dokumentit përmbarrimor - aktit noterial - Kontratës për pranim të borxhit, LRP.nr.9352/2022, numri i referencës 3641/2022 të datës 22.04.2022, me të cilën ka kërkuar që të aprovohet zgjerimi i propozimit për përmbarrim, të caktohet përmbarrimi ndaj debitorit A.SH. dhe detyrohet debitori që në emër të borxhit t'ia paguaj kreditorit shumën prej 5,903.95.00 €, si dhe shpenzimet e procedurës përmbarrimore nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

Përmbarruesi Privat në bazë të kërkesës për realizimin e përmbarrimit të kreditorit “Elektring” SH.P.K., me seli në Çagllavicë, kundër debitorit 1. “EL CORPORATION” SH.P.K., me seli në Gjilan dhe 2.A.SH. nga Gjilani, në bazë të dokumentit përmbarrimor – aktit noterial më datë 03.08.2022, ka aprovuar si të bazuar plotësim zgjerimin e propozimit për përmbarrim të kreditorit “Elektring” SH.P.K. ashtu që ka lejuar urdhërin përmbarrim edhe ndaj debitorit A.SH. sipas dokumentit përmbarrimor – aktit noterial LRP.nr. 9352/2022, Ref.nr. 3641/2022 të datës 22.04.2022.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor, e ka kundërshtuar në tërësi urdhrin përmbarrimor duke shtuar se dokumenti përmbarrimor – akti noterial është i kundërligjshëm pasi që marrëveshja për pagesën e borxhit është lidhur me “EL CORPORATION” SH.P.K., ndërsa pranimi i borxhit në emër të A.SH. - person fizik, është i kundërligjshëm dhe kontrata nuk prodhon efekte juridike. Më tutje i ka propozuar Gjykatës që të refuzohet si i pabazuar plotësim zgjerimi i propozimit për përmbarrim i propozuar nga “Elektring” SH.P.K., dhe të refuzohet Urdhri Përmbarrimor, P.nr.185/23 i datës 21.05.2023 si i kundërligjshëm.

Kreditori në përgjigjen në prapësim të paraqitur brenda afatit ligjor, ka kundërshtuar në tërësi si të pabazuara pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim, më tutje ka shtuar se prapësimi i debitorit i paraqitur më datën 16.08.2022 është i kundërligjshëm pasi që është përpiluar në kundërshtim me nenin 69 par.4 të Ligjit Nr. 04/L-139 dhe i njëjti nuk mbështetet në fakte dhe prova me anë të së cilave e kundërshton propozimin. Në prapësimin e paraqitur debitori kundërshton plotësim zgjerimin e propozimit, duke kundërshtuar Kontratën për pranim të borxhit, e cila është nënshkruar nga ana e kreditorit dhe debitorit me vullnetin e tyre të lirë të pa ndikuar nga askush dhe objekt i kësaj kontrate është borxhi në vlerë prej 5,903.95€. Andaj i ka

propozuar gjykatës që të refuzoj si të pabazuar prapësimin e debitorit “EL CORPORATION” SH.P.K., me seli në Gjilan dhe të lë në fuqi urdhri për lejimin e përmbarimit P.nr.185/22, i datës 21.05.2022 dhe debitori të ngarkohet me shpenzimet e procedurës.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes në prapësim të kreditorit si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit A.SH. është i bazuar për arsyet në vijim:

Gjykata nga shkresat e lëndës ka konstatuar se kreditori fillimisht ka paraqitur propozim për përmbarim kundër debitorit “EL CORPORATION” SH.P.K., duke u bazuar në dokumente të besueshme, përkatësisht fatura nr.138/2021 e datës 25.10.2021, fatura nr.552/2020 e datës 22.06.2020, fatura nr.715/2020 e datës 27.07.2020, fatura nr.971/2020 e datës 18.09.2020 dhe fatura nr.658/2020 e datës 13.07.2020 me të cilin ka detyruar debitorin që në emër të borxhit t’ia paguaj kreditorit shumën prej 5,903.95 €. Përmbaruesi Privat Besnik Aliu me Urdhërin P.nr. 185/2022 të datës 08.04.2022 ka lejuar përmbarimin ndaj debitorit dhe së bashku me propozimin për përmbarim i ka dorëzuar debitorit me datë 13.04.2022, ndaj të cilit urdhër debitorit i parë nuk ka paraqitur prapësim ashtu që i njëjti është bërë i plotfuqishëm.

Gjykata gjeti se Përmbaruesi Privat me Urdhërin e datës 03.08.2022 ka lejuar plotësim / zgjerimin e propozimit për përmbarim duke e zgjeruar urdhërin si në aspektin subjektiv ashtu edhe në aspektin objektiv, përkatësisht duke e zgjeruar edhe ndaj personit fizik A.SH. si dhe duke ndryshuar bazën ligjore të urdhërit nga dokumenti i besueshëm në dokument përmbarimor.

Lidhur me këtë, gjykata vlerëson se plotësim / zgjerimi i propozimit për përmbarim është nxjerrë nga Përmbaruesi Privat Besnik Aliu në tejkalim të bazë ligjore të Urdhërit P.nr. 185/2022 të datës 08.04.2022 i cili ishte nxjerrë në bazë të dokumenteve të besueshme, andaj plotësimi / zgjerimi i urdhërit përmbarimor ka mundur të bëhet vetëm mbi këtë bazë, por jo të ndryshohet baza e urdhërit përmbarimor sic është vepruar me urdhërin plotësues të datës 03.08.2022.

Neni 38 par.1 i LPP-së përcakton se: *“1. Propozimi për përmbarim duhet ta përmbajë kërkesën për përmbarim në të cilën do të tregohet dokumenti përmbarimor origjinal apo kopje e vërtetuar, apo dokumenti i besueshëm në bazë të cilit kërkohet përmbarimi, kërkuesi i përmbarimit dhe debitori, adresa e vendbanimit – vendqëndrimit apo selisë afariste të kreditorit dhe të debitorit, kredia që kërkohet të realizohet, si dhe mjeti nëpërmjet cilit duhet kryer përmbarimi, objekti i përmbarimit po qe se është i njohur, si dhe të dhënat e tjera që janë të nevojshme për zbatimin e*

*përmbarimit.*”, ashtu që gjykata vlerëson se në kundërshtim me këtë dispozitë është lejuar propozimi i kreditorit për zgjerimin e propozimit për përmbarim pasi që propozimi për përmbarim mund të paraqitet vetëm në njëërën bazë dhe atë në bazë të dokumentit të besueshëm apo dokumentit përmbarimor por nuk mund të paraqitet mbi dy bazat ligjore.

Nga arsyet e paraqitura më lartë dhe duke u bazuar në nenin 73 par.1 dhe par. 3 të LPP-së, nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

## GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.685/23, datë 20.06.2024

Gjyqtari

Arnis Dumani

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi, palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimi të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale, të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.